



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 12 Prot.

Durrës më, 06/01 /2022

V E N D I M

Nr. 2 Datë 06/01 2022

**"Për shpalljen e aplikimeve për anëtar të Bordit të Administrimit përfaqësues të Universitetit
"Aleksandër Moisiu" Durrës"**

Në mbështetje të nenit 38 pika 1 gërma gj, nenit 48 të ligjit nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", të nenit 33 të Statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, vendimit të Bordit të Administrimit nr.1, datë 09.01.2017, Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Shpalljen e aplikimeve për anëtar të Bordit të Administrimit përfaqësues të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.
2. Kandidatët për anëtar të Bordit të Administrimit përfaqësues të UAMD vetëkandidohen, ose propozohen nga njësitë bazë përkatëse.
3. Kandidatët do të dorëzojnë pranë Sekretarisë së Senatit Akademik dokumentacionin si mëposhtë:
 - a) Kërkesën për kandidim;
 - b) Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale;
 - c) Deklarimin se nuk ka asnjë masë disiplinore në fuqi;
 - d) Vërtetimi i punës;
 - e) Kopje e titullit akademik/gradës shkencore;
 - f) Kopje të dokumentit të identifikimit.
4. Afati për dorëzimin e dokumentacionit është nga data 07.01.2022 deri në datën 12.01.2022.
5. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar Sekretaria e Senatit Akademik, do të përcjellë listën e kandidaturave të regjistruara për votim në Senatin Akademik.
6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Dekanët e Fakulteteve
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
Prof. Dr. Kresencja SOTIROFSKI